



Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës

Thirrje për aplikim për Psikolog/e

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Përshkrimi i punës:

Pozita:

Numri i pozitave:

Vendi:

Angazhimi:

Data e nisjes:

Ofrimi i shërbimeve psikologjike

Psikolog/e

2 (dy)

Prishtinë, Kosovë

Orar i plotë

Shtator/Tetor 2026

RRETH QKRMT-SË

QKRMT është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1999 që ofron shërbime ndërdisiplinore në mbështetje të viktimave civile të luftës, veçanërisht të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Më tej, QKRMT-ja është e përfshirë në identifikimin, vlerësimin, trajtimin, referimin dhe monitorimin e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore në mesin e të riatdhesuarve dhe personave me shqetësim për UNHCR-në (të kthyerit, refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit dhe personat në rrezik të pa shtetësisë).

Gjithashtu, në kuadër të mandatit të saj për të promovuar dhe avancuar respektimin e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria, QKRMT kryen vizita të rregullta monitoruese në vendet si: burgje, qendra të paraburgimit, qelitë e paraburgimit të policisë, institucionet e shëndetit mendor dhe gjithashtu promovon praktikën dhe standardet legjislative për mbrojtjen dhe ngritjen e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria.

QKRMT-ja e sheh rolin e saj në shoqëri si ofrues i shërbimeve dhe mbikëqyrës i të drejtave të njeriut. Me rëndësi të veçantë ka qenë përpjekja e vazhdueshme dhe e fuqishme avokuese që ka bërë QKRMT me institucionet qeveritare në adresimin e nevojave të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, si dhe personave të privuar nga liria.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Ofrimi i mbështetjes psikosociale për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës dhe/ose për personat e riatdhesuar dhe refugjatë me histori të traumës dhe shqetësimeve psikologjike.
- Realizimi i seancave individuale dhe grupe të terapisë që synojnë adresimin e traumës, menaxhimin e stresit dhe promovimin e shërimit.
- Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të trajtimit të përshtatura për secilin të mbijetuar bazuar në nevojat dhe përvojat e tyre unike.
- Monitorimi i vazhdueshëm i përparimit të klientëve dhe përshtatja e planeve të trajtimit sipas nevojave.
- Bashkëpunimi me anëtarë të tjerë të ekipit multidisiplinor për të siguruar kujdes dhe mbështetje holistike për të mbijetuarit.



- Organizimi i seminareve dhe punëtorive.
- Prezantimi i temave të rëndësishme në punëtori mbi çështje të shëndetit mendor, teknika terapeutike dhe qasje profesionale.
- Përgatitja e raporteve të rregullta dhe raportimi tek mbikëqyrësi për përparimin e klientëve, vlerësimet, planet e trajtimit dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën terapeutike.
- Mbajtja e regjistrave të sakta dhe të besueshme të ndërveprimeve të klientëve, vlerësimeve dhe planeve të trajtimit në përputhje me politikat e organizatës dhe etikën profesionale.
- Përmbytja e detyrave të tjera që përcaktohen nga mbikëqyrësi, duke përfshirë projekte të veçanta, përmirësime të proceseve, ose detyra administrative që ndihmojnë në funksionimin e përgjithshëm të organizatës.

KUALIFIKIMI, PËRVOJA & SHKATHTËSITË/ Të gjitha fushat e mëposhtme janë obligative

- Diplomë universitare në Psikologji.
- Përvojë klinike në ofrimin e këshillimit, trajtimit psikologjik dhe shërbimeve tjera për grupet e cënueshme (minimalisht 2 vjet).
- Kuptim i nevojave dhe sfidave psikosociale që përballen të mbijetuarit, si dhe faktorëve kulturorë dhe kontekstual që ndikojnë në shërimin e tyre.
- Aftësi për vlerësim, ndërhyrje terapeutike, hartim dhe përshtatje të planeve individuale të trajtimit, si dhe monitorimin e progresit të klientëve.
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikimi, si dhe aftësi për të krijuar marrëdhënie të mira terapeutike me klientë të ndryshëm.
- Fleksibilitet, gatishmëri për punë ekipore;
- Përkushtim për aplikimin e standardeve etike, si dhe për ruajtjen e besimit të klientit.
- Gatishmëri për të mësuar dhe zhvilluar profesionalisht dhe personalisht;
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze.
- Posedimi i patentë-shoferit të kategorisë B dhe përvojë praktike në vozitje të pavarur.

PROCESI I APLIKIMIT

Personat e interesuar ftohen të dorëzojnë **CV-në dhe letrën motivuese**, duke shënuar në subjekt **emrin e pozitës**, në info@krct.org jo më vonë se **10.09.2026**

Shënim:

- Propozimet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen për proces të mëtejshëm. Aplikimet e dorëzuara pas kohës së përcaktuar nuk do të vlerësohen.
- Vetëm kandidatët në listë të ngushtë do të ftohen për intervistë.

